URDHËR
Nr. 4492, datë 5.11.2012

PËR DELEGIM TË DISA KOMPETENCAVE SHEFIT TË QENDRËS SË DOKTRINËS

Mbështetur në nenin 35, pika 2 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 339, datë 12.3.2012 "Për miratimin e rregullores së procedurave të botimeve doktrinare", si dhe për arsye të detyrimeve që rrjedhin nga përmbushja e misionit dhe përgjegjësive të Qendrës së Doktrinës,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Komandantit të Doktrinës dhe Stërvitjes te Shefi i Qendrës së Doktrinës, për komunikim të drejtpërdrejtë me struktura të FA-së, si dhe për firmosjen e praktikave të:
- fushës së standardizimit;
- fushës së hartimit të doktrinës dhe manualeve;
- fushës së zhvillimit të koncepteve dhe mësimeve të nxjerra;
- hartimin e direktivave programore;
- lëshimin e vërtetimeve për personelin e Qendrës së Doktrinës për efekt dokumentacioni, përjashtuar atyre me efekt financiar;
- ngritjen e komisionit të veçantë për përllogaritjen e honorarëve për hartuesit e materialeve doktrinare (strategji, doktrina, manuale, rregullore, revistë, studime).

2. Përjashtohet nga ky delegim autoriteti i komunikimit të drejtpërdrejtë me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, zëvendësshefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe komandantët e forcave dhe ato mbështetëse.

3. Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhri Shefi i Qendrës së Doktrinës.

4. Ndjek zbatimin e urdhrit zv/komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

GJENERAL BRIGADE
KOMANDANTI I KDS
Bardhyl Hoxha